



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova*  
**Ministria e Punëve të Brendshme/ Ministarstvo Unutrasnjih Poslova/ Ministry Of  
Internal Affairs**

---

**PLANI I REAGIMIT PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË MUNDSHËM TË  
MIGRANTËVE, REFUGJATËVE DHE APLIKUESVE PËR MBROJTJE  
NDËRKOMBËTARE**

**Prishtinë, 2021**

## **Hyrje**

Kosova ende nuk është prekur nga lëvizjet e mëdha të flukseve migratore për shkak të pozitës gjeografike dhe për arsye të ndryshme. Mirëpo, vlerësimet dhe parashikimet e mekanizmave të specializuar vendor dhe ndërkombëtar që monitorojnë lëvizjet migratore, japin indikacione që fluksi i migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare nuk do të ndalet në një të ardhme të afërt dhe se rrugëtimi do të jetë i vazhdueshëm dhe do të ketë zhvillime të ndryshme. Në dritën e supozimeve se rrugët e lëvizjeve migratore papritmas mund të ndryshojnë dhe Kosova të bëhet vend transiti apo destinacioni për migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, e bën të domosdoshme ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve nga ana e autoriteteve përkatëse për të mundësuar qasje të papenguar në territor dhe në shërbimet përkatëse. Indikacionet për një fluks të mundshëm me migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtje ndërkombëtare reflektojnë edhe zhvillimet e fundit në Afganistan.

Andaj, bazuar në përvojën e vendeve tjera të cilat tashmë janë përballur me fluksin e migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe bazuar në vlerësimet e bëra se mund të ketë fluks të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare edhe në vendin tonë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur planin e reagimit për menaxhimin e këtij fluksi të mundshëm.

## **Qëllimi**

Qëllimi i këtij plani është menaxhimi i fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, duke definuar veprimet përgatitore dhe të reagimit në mënyrë të koordinuar nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Ky plan ofron vizionin e qartë përmes qëllimeve strategjike, si dhe përcakton autoritetet kompetente, organizatat dhe përgjegjësitë e tyre në rast të fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe masat e aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe burimet e nevojshme për zbatimin e këtij plani.

Në plan janë të paraparë pesë skenarë të mundshëm, masat e reagimit për secilin skenar, afatet kohore, si dhe kostoja për zbatimin e secilit aktivitet.

Plani do të rishikohet çdo dy vite apo më shpesh, sipas nevojës.

## **Parimet bazë**

Plani për Menaxhimin e Fluksit të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, garanton respektimin e të drejtave të njeriut, migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, bazuar në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar.

Parimet bazë që janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të këtij plani janë:

- Mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut;
- Parimi i moskthimit;
- Përmbushja e obligimeve ndërkombëtare;
- Ruajtja e rendit dhe qetësisë;
- Ruajtja e shëndetit publik;
- Ruajtja e sigurisë kombëtare;
- Përgjigjja kolektive ndaj fenomenit me solidaritet.

Përveç parimeve të lartcekura, autoritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të garantojnë respektimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve respektive, si dhe Deklaratës së Luksemburgut të datës 08 tetor, 2015.

## **Autoritetet përgjegjëse**

Me qëllim të planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të parapara në këtë plan, do të përfshihen autoritetet relevante vendore dhe ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Brendshme, përmes Koordinatorit Kombëtar për Migrim, do të bashkërendoj të gjitha autoritetet që rrjedhin nga ky plan.

Autoritetet vendore të përfshira në Planin për Menaxhimin e Fluksit të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare janë:

- ZKM - Zyra e Kryeministrit;
- MPB - Ministria e Punëve të Brendshme;
- MPJD - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- MM – Ministria e Mbrojtjes;
- MFPT- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- MSH - Ministria e Shëndetësisë;
- MPL - Ministria e Pushtetit Lokal;
- KSK - Këshilli i Sigurisë i Kosovës;
- Komunat.

Institucionet ndërkombëtare me mandat dhe kompetenca të përcaktuara me normativin në fuqi:

- KFOR-i.

Institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare që do të ndihmojnë për menaxhimin e fluksit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare janë:

- Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë - UNHCR;
- Organizata Ndërkombëtare për Migracion - IOM;
- Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara - UNICEF;
- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq - ICRC;
- Kryqi i Kuq i Kosovës;
- Organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.

Koordinatori Kombëtar për Migrim, me vendim, themelon grupin ndërinstitucional për zbatimin e këtij plani.

DSHAM njofton Grupin Ndërinstitucional për Menaxhimin e Fluksit të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, si dhe institucionet dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare rreth zbatimit të këtij plani.

### **Përshkrimi i gjendjes në rajon**

Që nga marsi i vitit 2016, pas adoptimit të marrëveshjes BE-Turqi e shoqëruar me mbylljen e kufijve ndaj Ballkanit Perëndimor, numri i migrantëve dhe refugjatëve në brigjet e Greqisë, të cilët synonin të lëviznin drejt Evropës Perëndimore dhe Veriore pësoi rënie të dukshme. Megjithatë një numër i konsiderueshëm vazhdojnë të arrijnë në BE: në Greqi përmes Turqisë, në Itali dhe Spanjë përmes mesdheut. Në vitin 2016 në Evropë u regjistruan 390,005 migrantë dhe refugjatë të rinj, më 2017-188,372, më 2018-147,683, më 2019-128,536, më 2020 – 99,475 migrantë dhe refugjatë. Prej muajit janar deri në shtator të vitit 2021 u regjistruan 90,879 (67,960 përmes detit dhe 22,919 rrugëve tokësore) migrantë dhe refugjatë. Shihet një rënie prej 25% e numrit të migrantëve të rinj gjatë vitit 2020 në krahasim me vitin 2019, kjo si pasojë e masave shtrënguese në fuqi që aplikuan shtetet e destinacionit për të parandaluar përhapjen e pandemisë. Por gjatë nëntë muajve të vitit 2021, shihet prapë rritje e numrit të migrantëve dhe refugjatëve të rinj që sipas trendit është për 30% më e lartë se në vitin 2020. Sipas të dhënave të fundit në rajon (Greqi dhe shtetet e Ballkanit Perëndimor) janë prezent 62,600 migrantë dhe refugjatë (Gusht 2021). Në numër më të madh janë në Greqi 52,679, Bosnjë dhe Hercegovinë 2,839 dhe në Serbi 3,879. Lëvizjet migratore nga Greqia kanë vazhduar në dy drejtime, përmes Maqedonisë Veriore dhe Serbisë, si dhe përmes Shqipërisë dhe Malit të Zi dhe duke u mbyllur në Bosnjë e Hercegovinë. Kosova është prekur në mënyrë sporadike nga grupe më të vogla në numër, por gjatë vitit 2020 regjistrohen 2,879 persona, një rritje e dukshme e numrit të migrantëve të rinj në krahasim me vitet paraprake. Gjatë vitit 2021 ( Janar – Gusht ) janë regjistruar 800 persona. Sa i përket numrit të përgjithshëm të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare në rajon (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni Veriore,

Kosovë) dhe Greqi, gjatë vitit 2020 kanë qenë rreth 56,000 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, ku numri më i lartë ishte në Greqi. Viti 2020 ka shënuar një rënie të numrit të aplikacioneve krahasuar me vitet paraprake, ku trendi 2016 – 2019 në këto vende tregonte një rritje të vazhdueshme (nga 62,000 në vitin 2016, në 98,000 në vitin 2019).

Kosova është prekur në mënyrë sporadike nga grupe më të vogla në numër.

## **Përshkrimi i gjendjes në Kosovë**

Për shkak të pozitës gjeografike të saj, Kosova ndodhet në mes të dy rrugëve kryesore të cekura më lart duke ofruar një vend të përshtatshëm për të transituar nga njëra linjë në tjetrën. Një mundësi e tillë ka ofruar edhe rritjen e kontrabandimit i cili është shfrytëzuar në vazhdimësi, si gjatë viteve 2018, 2019, 2020 po ashtu edhe gjatë nëntëmujorit të vitit 2021. Prandaj, Kosova po ashtu përjetoj një rritje të konsiderueshme por stabile të numrit të aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatëve dhe migrantëve. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 594 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare, në vitin 2019 janë regjistruar 2081, kurse në vitin 2020 janë regjistruar 1,409 aplikues për mbrojtje ndërkombëtare. Në vitin 2021 numri i të ardhurve të rinj ka variuar për shkak të rrethanave të gjithmbarshme si pasojë e pandemisë, duke shënuar një numër prej 479 aplikuesve nga janari deri në shtator, që përsëri paraqet një shifër brengosëse e cila kërkon përgatitje të mëtejme në mënyrë të koordinuar për adresim të duhur. Një element kyç i cili do ta determinonte qasjen dhe parapërgatitjen për reagim të duhur, është kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në Kosovë.

Ndonëse gjatë vitit 2019 dhe 2020 është shënuar numër i konsiderueshëm i aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare, qëndrimi relativisht i shkurtër i tyre në Kosovë, mesatarisht 20 deri në 25 ditë, ka mundësuar reagimin e duhur të autoriteteve në ofrimin e të gjitha shërbimeve përkatëse në kohë adekuate, përderisa rrethanat e shfaqura si pasojë e pandemisë COVID-19 kanë ndikuar në vazhdimësi në qëndrimin më të gjatë, mesatarisht 30 deri 35 ditë, të aplikuesëve për mbrojtje ndërkombëtare në numër më të madh dhe në momente të caktuara ka sfiduar kapacitetet reaguese të autoriteteve, të cilat në koordinim me organizata të numërta ndërkombëtare dhe vendore kanë arritur t'i ofrojnë shërbimet e duhura.

Në bazë të planit paraprak, autoritetet kanë hyrë në fazën e dytë të atij plani me funksionalizimin e objekteve të pritjes, Qendra e Përkohshme e Pritjes së Migrantëve në Vranidoll, Qendrës së Azilit në Vranidoll dhe një pjesë të objekteve në kampin "Bellvedere".

Përvoja e fituar nga kjo periudhë do të shfrytëzohet maksimalisht për përgatitjen e duhur të të gjitha kapaciteteve reaguese në mënyrë të koordinuar. Kjo përvojë po ashtu është marrë si bazë për rishikimin e planit të reagimit.

Me aktivizimin e nenit 52 të Ligjit për Azil në fund të janarit të vitit 2020, që u jep mundësi migrantëve dhe refugjatëve të aplikojnë " Për shprehjen dhe qëllimin për të kërkuar azil" dhe të kenë mundësinë që brenda 72 orëve të vendosin për aplikim për mbrojtje ndërkombëtare, kemi një situatë të re me migrantë dhe refugjatë të rinj. Nga 31 janari i vitit 2020, kur dhe ka hyrë në fuqi 72

orësh-i “ Shprehja e qëllimit për të kërkuar azil”, e deri në dhjetor të vitit 2020, janë regjistruar 1,532 migrantë dhe refugjatë në Zyrat e Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj të Policisë së Kosovës. Nëse i marrim shifrat e migrantëve dhe refugjatëve që iu është lëshuar 72 orësh-i “ Shprehja e qëllimit për të kërkuar azil” dhe atyre që kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, na rezulton se nga janari deri dhjetor të viti 2020, në Kosovë kanë hyrë 2,941, ndërsa nga janari deri në shtator të vitit 2021, janë regjistruar 1,223 migrantë dhe refugjatë.

Të gjitha këto të dhëna tregojnë qartë mbi rritjen graduale të numrit të të ardhurve të rinj, si dhe domosdoshmërinë për aprovimin e këtij plani në mënyrë që të arrihet qëllimi i tij dhe të përmbushen obligimet bazuar në legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar.

### **Rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19**

Me vazhdimin e rrethanave si pasojë e pandemisë, menaxhimi i flukseve të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare do të bëhet edhe më sfiduese dhe kërkon veprim të koordinuar për të siguruar mbrojtjen shëndetësore të migrantëve, refugjatëve dhe të zyrtarëve që merren me këto kategori.

Përfshirja e këtyre kategorive në planet e Qeverisë për parandalim, mbrojtje dhe reagim ndaj pandemisë, duke përfshirë sigurimin e koordinuar dhe në kohë të materialeve dhe mjeteve të nevojshme për parandalimin e përhapjes së pandemisë, si për mbrojtjen personale, higjienën dhe dezinfektimin për nevojat e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, refugjatëve dhe migrantëve duhet të vazhdojë. Po ashtu, përfshirja e tyre proporcionale në programin e vaksinimit të autoriteteve kombëtare të shëndetit publik në kohë të duhur është esenciale dhe duhet të vazhdojë të aplikohet.

### **Prezenca e lirë në vende publike dhe opinionin publik**

Numri i shtuar i aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, migrantëve dhe refugjatëve dhe frekuentimi i lirë në zonat urbane dhe përfshirja e herëpashershme e një numri të tyre në incidente të ndryshme, siç edhe është provuar deri me tani, mund të çojnë në rritje të tensioneve dhe incidenteve midis tyre dhe komuniteteve vendore dhe si pasojë mund të nxisë urrejtje apo ksenofobi ndaj tyre.

Raportimet e ndryshme, si në rrjetet sociale ashtu edhe në media mund ta thellojnë një urrejtje të tillë më tutje, në mënyrë të gjeneralizuar gjë që do ta vështirësonte punën efikase të autoriteteve por edhe do të ndikonte negativisht në të drejtat e ligjshme të këtyre kategorive. Autoritetet përgjegjëse do t’i marrin masat që të parandalojnë dhe adresojnë incidentet eventuale, si dhe të mbështesin marrëdhëniet e mira dhe kohezionin shoqëror midis këtyre kategorive dhe komuniteteve vendore. Konferencat për media nga autoritetet përgjegjëse, do të luajnë rol kyç në raportimin real, objektiv dhe të paanshëm rreth zhvillimeve të ndërlidhura me fluksin me migrantë, refugjatë dhe aplikues për mbrojtje ndërkombëtare.

## Pikat e mundshme të hyrjes dhe daljes së migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve potencial në territorin e Republikës së Kosovës

Bazuar në vlerësimet dhe analizat nga institucionet përgjegjëse, lidhur me kapacitetet e pranimit, akomodimit dhe trajtimit të migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve potencial, janë planifikuar masat e nevojshme për të menaxhuar situatën. Në kuadër të kësaj janë përgatitur disa skenarë për pikat e mundshme hyrëse dhe dalëse:

Pikat kryesore dhe dytësore të hyrjes dhe daljes së migrantëve, refugjatëve dhe aplikuesve potencial në territorin e Republikës së Kosovës sipas vlerësimit të tanishëm janë:	
Pikat e mundshme të hyrjes dhe daljes në Kosovë nga kufiri me Serbinë.	Stublina, Gjilan – Pikë dytësore e hyrjes
	Karaqevë, Kamenicë – Pikë dytësore e hyrjes
	Muqibabë, Gjilan – Pikë dytësore e hyrjes
	Bërnjak, Zubin Potok – Pikë dytësore e hyrjes dhe daljes
	Jarinjë, Leposaviq – Pikë dytësore e hyrjes dhe daljes
Pikat e mundshme të hyrjes dhe daljes në Kosovë nga kufiri me Shqipërinë.	Vërmicë, Prizren – Pikë kryesore e hyrjes
	Qafa e Prushit, Qafa e Morinës, Gjakovë – Pika kryesore të hyrjes
	Shishtavec, Orqush, Borjë, Dragash – Pika kryesore të hyrjes
Pikat e mundshme të hyrjes dhe daljes në Kosovë nga kufiri me Maqedoninë e Veriut.	Hani i Elezit – Pikë kryesore e hyrjes
	Stanqiq, Gjilan – Pikë kryesore e hyrjes
	Dobellde, Viti – Pikë dytësore e hyrjes
Pikat e mundshme të hyrjes dhe daljes nga Kosova në kufirin me Malin e Zi.	Kulla, Peja – Pikë dytësore e hyrjes

### Monitorimi i kufirit dhe shkëmbimi i informacionit me shtetet fqinje dhe me komunitetin lokal

Në rast të indikacioneve për ndonjë fluks të mundshëm, Policia e Kosovës do t'i ngritë kapacitetet dhe do të përcjell informacionet tek autoritetet kompetente për marrjen e veprimeve të mëtutjeshme.

### Indikatorët për aktivizim të planit

Aktivizimi i planit të reagimit do të bëhet duke u bazuar në indikatorët të cilët do të kalkuloohen sipas numrit të personave që hyjnë, atyre që largohen, si dhe atyre që do të qëndrojnë brenda një afati të caktuar kohor. Për këtë qëllim, të gjitha lëvizjet do të monitorohen me kujdes dhe informatat e rregullta dhe të shpejta do të këmbehen nga akterët përgjegjës, përfshirë këtu Policinë e Kosovës, autoritetet e azilit, si dhe ato të migrimin. Indikatorin e përgjithshëm do të jetë përcaktuesi kryesor për aktivizim të planit dhe si i tillë është i domosdoshëm për menaxhim të rrjedhshëm në zbatimin e planit. Për kalimin nga njeri skenar në tjetrin, do të aplikohen indikatorët specifik siç edhe janë të cekur më tej në këtë plan.

### **Indikatori i përgjithshëm për aktivizim të planit është paraqitur në tabelën e mëposhtme:**

<b>Hyrja</b>			<b>Largimi (rreth 85%)</b>	<b>Persona që qëndrojnë për 7 ditë radhazi (rreth 15%)</b>
<b>Ditore</b>	<b>Mujore</b>	<b>Totali në 3 Muaj</b>		
15	450	1350	1150	200

Koordinatori Kombëtar për Migrim dhe DSHAM, do ta menaxhojnë këmbimin e informatave me qëllim të inicimit të aktivizimit të planit, si dhe njoftimit të hershëm të Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Fluksit të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare, si dhe institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare për aktivizimin e tij dhe koordinimit për zbatimin. Koordinatorin Kombëtar për Migrim dhe DSHAM, po ashtu do ta themelojnë një grup të caktuar për identifikimin e nevojave për mbështetje dhe avokim me donatorët e mundshëm në mënyrë të koordinuar.

### **Ngritja e pikës dhe Qendra e Pritjes për Migrantë**

MPB-ja do të merr masat për vendin se ku do të ngriten Pikat e Pritjes dhe Qendra e Përkohshme për Migrantë.

### **Menaxhimi i pikës së pritjes**

Pikat e Pritjes dhe Qendra e Përkohshme e Pritjes së Migrantëve menaxhohen nga MPB.

### **Regjistrimi**

Të gjithë ata që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës, do të regjistrohen nga Policia e Kosovës dhe DSHAM-ja në formularët përkatës. Do të merren shenjat e gishtërinjve, si dhe do të bëhet fotografimi i tyre.

Në rast se ka fluks të madh të migrantëve në Republikën e Kosovës, e që nuk kanë kërkuar azil, dhe autoritetet kompetente nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t'i regjistruar të gjithë, atëherë ky regjistrim bëhet në bazë të një profilizimi paraprak.

Të dhënat e mbledhura përgjatë regjistrimit do të futen në bazën e të dhënave të DSHAM-së.

Regjistrimi i parashtruesve të kërkesës për azil, bëhet sipas procedurave të parapara me Ligjin për Azil në Republikën e Kosovës.

- Grupi punues duhet të vlerësoj situatën, dhe përcakton metodologjinë e regjistrimit;
- Përgatit një regjistër me staf dhe staf shtesë për regjistrim emergjent;
- Organizon një vend të përshtatshëm të pritjes për regjistrim;
- Përgatit dhe përditëson informatat që duhet të ndahen me migrantët dhe refugjatët përgjatë regjistrimit;
- Të ngritet kapaciteti i stafit emergjent të regjistrimit përmes trajnimeve;
- Të bëhet regjistrimi përmes lap-topëve dhe PC-ve;



- Grupi punues nxjerr udhëzime në lidhje me ofrimin e shërbimeve për migrantët dhe refugjatët që janë në pritje nëpër pikat e pritjes.

**Pikat e Pritjes<sup>1</sup> dhe Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, si dhe objektet apo Qendrat për Akomodimin e Aplikuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare dhe Refugjatëve:**

1. Pikat e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, afër kufirit në hyrje dhe/apo në dalje të Kosovës;
2. Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, në Vranidoll;
3. Qendra për Azil, në Magurë të Lipjanit, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare;
4. Qendra për Azil, në Vranidoll, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve;
5. Qendra për Azil- Kampi ‘‘Bellvedere’’ në Mitrovicë, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve.

<b>PIKAT E PRITJES PËR MIGRANTË</b>			
<b>Strehimi</b>	<b>Kapaciteti aktual</b>	<b>Kapaciteti i planifikuar</b>	<b>Total</b>
Pikat e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, afër kufirit në hyrje dhe dalje të Kosovës.	//	1000	1000
<b>Total:</b>			1000
<b>QENDRA E PRITJES SË PËRKOHSHME PËR MIGRANTË</b>			
<b>Strehimi</b>	<b>Kapaciteti aktual</b>	<b>Kapaciteti i planifikuar</b>	<b>Total</b>
Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, në Vranidoll.	60	//	60
<b>Total:</b>	60	0	60
<b>QENDRA PËR AZIL DHE OBJEKTET E SAJ PËR AKOMODIMIN APLIKUESVE DHE REFUGJATËVE</b>			
<b>Strehimi</b>	<b>Kapaciteti aktual</b>	<b>Kapaciteti i planifikuar</b>	<b>Total</b>
Qendra për Azil, në Magurë të Lipjanit, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.	100	//	100
Qendra për Azil, në Vranidoll, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve.	116	//	116
Qendra për Azil- Kampi ‘‘Bellvedere’’ në Mitrovicë, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve.	500	1,700	2200
<b>Total</b>	<b>716</b>	<b>1,700</b>	<b>2,416</b>

<sup>1</sup> Sqarim: Pikat e Pritjes janë objekte të përkohshme mobile për regjistrimin e migrantëve dhe trajtimin fillestar, me kapacitet maksimal të procesimit deri në 1,000 persona brenda një dite.

Pjesë e këtij dokumenti janë planet tabelore sipas skenarëve:

1. Plani tabelor, skenari 1,
2. Plani tabelor, skenari 2,
3. Plani tabelor, skenari 3,
4. Plani tabelor, skenari 4,
5. Plani tabelor, skenari 5.

## **PLANI I REAGIMIT PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË MUNDSHËM TË MIGRANTËVE, REFUGJATËVE DHE APLIKUESVE PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE, I PARAQITUR NË FORMË TABELORE NË KATËR SKENARË:**

**Skenari 1:** Kur ka fluks të vazhdueshëm të migrantëve dhe refugjatëve që qëndrojnë në vend për periudhë të shkurtë kohore, do të themelohen Pikat e Pritjes për Migrantë, afër pikave hyrëse dhe dalje të kufirit në Kosovë.

**Skenari 2:** Kur ka migrantë që gjenden në thellësi të territorit të Kosovës dhe që qëndrojnë në vend për periudhë të shkurtë kohore, do të shfrytëzohet Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë në Vranidoll, që ka kapacitet për akomodimin e 60 migrantëve.

**Skenari 3:** Kur refugjatët qëndrojnë më gjatë në shtet dhe shprehin interesin për të kërkuar azil, do të akomodohen në Qendrën për Azil në Magurë që ka kapacitet për akomodimin e 100 aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.

**Skenari 4:** Kur refugjatët qëndrojnë më gjatë në shtet dhe shprehin interesin për të kërkuar azil, dhe në rastet kur Qendra për Azil në Magurë që ka kapacitet për akomodimin e 100 aplikuesve është e mbushur vazhdimisht për shtatë ditë rresht, aktivizohen dy objektet e Qendrës për Azil në Vranidoll, të cilat kanë kapacitet për akomodimin e 116 aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare apo në rast nevojë dhe për akomodimin e refugjatëve;

**Skenari 5:** Kur refugjatët qëndrojnë më gjatë në shtet dhe shprehin interesin për të kërkuar azil, dhe në rastet kur dy objektet e Qendrës për Azil në Vranidoll, për akomodimin e 116 aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare, janë të mbushura vazhdimisht për shtatë ditë rresht, atëherë aktivizohet kampi "Bellvedere" në Mitrovicë, që ka kapacitet për akomodimin e 2,200 aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare apo në rast nevojë edhe për akomodimin e refugjatëve.

### **Shënim:**

1. Pikat e Pritjes për Migrantë dhe Qendra e Pritjes së Përkohshme për Migrantë, në skenarët 1 dhe 2, do të jenë në varësi të MPB-së, dhe për menaxhimin e tyre do të caktohet nga një zyrtar përgjegjës.
2. Kryesuesi i Grupit Ndërinstitucional për Menaxhimin e Fluksit të Mundshëm të Migrantëve, Refugjatëve dhe Aplikuesve, vendos për kalimin nga njëri skenar në skenarin tjetër sipas një vlerësimi paraprak, të bërë nga DSHAM dhe Policia e Kosovës.

**PLANIFIKIMI BUXHETOR PËR THEMELIMIN E QENDRAVE TË PRITJES SË PËRKOHSHME PËR MIGRANTË, RENOVIMIN E OBJEKTEVE DHE RRYTJEN E KAPACITETEVE NË OBJEKTET PËR AKOMODIMIN E MIGRANTËVE, REFUGJATËVE DHE APLIKUESVE PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE:**

<b>THEMELIMI I QENDRAVE TË PRITJES SË PËRKOHSHME PËR MIGRANTË</b>	<b>Kosto buxhetore</b>	<b>Kosto shtesë buxhetore</b>	<b>Totali në €</b>
<b>Skenari 1:</b> Themelimi i Pikave të Pritjes për Migrantë, afër pikave hyrëse për 1000 persona dhe dalje për 1000 persona.	391,800.00	0.00	<b>391,800.00</b>
<b>Skenari 2:</b> Funkcionalizimi dhe administrimi i Qendrës së Pritjes së Përkohshme për Migrantë në Vranidoll.	293,300.00	0.00	<b>293,300.00</b>
<b>Gjithsejtë</b>	685,100.00		<b>685,100.00</b>
<b>OBJEKTET PËR AKOMODIMIN E APLIKUESVE DHE REFUGJATËVE</b>			
<b>OBJEKTET PËR AKOMODIMIN E APLIKUESVE DHE REFUGJATËVE</b>	<b>Kosto buxhetore</b>	<b>Kosto shtesë buxhetore</b>	<b>Totali</b>
<b>Skenari 3:</b> Rritja e kapaciteteve në Qendrën për Azil në Magurë të Lipjanit, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare.	<b>241,750.00</b>	0.00	<b>241,750.00</b>
<b>Skenari 4:</b> Rritja e kapaciteteve në objektet e Qendrës për Azil në Vranidoll, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve.	<b>367,240.00</b>	0.00	<b>367,240.00</b>
<b>Skenari 5:</b> Rritja e kapaciteteve në objektet e Qendrës për Azil - Kampi ‘Bellvedere’ në Mitrovicë, për akomodimin e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare dhe refugjatëve.	<b>5,101,867.86</b>	0.00	<b>5,101,867.86</b>
<b>Gjithsejtë</b>	<b>5,710,857.86</b>	<b>0.00</b>	<b>5,710,857.86</b>
<b>Totali i përgjithshëm për pesë skenarët e këtij plani</b>	<b>6,395,957.86</b>	<b>0.00</b>	<b>6,395,957.86</b>

**Skenari 1:** Kur ka fluks të vazhdueshëm të migrantëve apo refugjatëve që qëndrojnë në vend për periudhë të shkurtë kohore, do të themelohen Pikat e Pritjes për Migrantë, afër pikave kufitare hyrëse dhe dalëse të Kosovës.

Kjo situatë do të aplikohet kur një numër i konsiderueshëm i migrantëve apo refugjatëve kanë hyrë në territorin e Kosovës dhe të cilët nuk shprehin interesin për të kërkuar azil dhe shfrytëzojnë territorin e Kosovës si transit. Në këtë rast kërkohet të themelohen Pikat e Pritjes për Migrantë, si vende grumbullimi të migrantëve apo refugjatëve.

Prezenca e migrantëve apo refugjatëve në Pikat e Pritjes tek kufiri nuk duhet të jetë më shumë se 200 persona në pritje për procedim të mëtejshëm në një periudhë prej **3 ditësh**.

Ndërmarrja e aktiviteteve të parapara në situatën 1 janë me prioritet pasi që ata duhet të sigurojnë:

- Vendosja e migrantëve apo refugjatëve në një vend, tek "Pikat e Pritjes së Përkohshme për Migrantë" do të ndihmojë në ofrimin e kushteve higjienike në nivelin e duhur;
- Mbrojtja e migrantëve apo refugjatëve prej elementeve mjedisore: dielli, shiu, era si dhe për të ofruar sigurinë e tyre dhe mundësinë për të pushuar;
- Qasje në kushte themelore të higjienës/sanitari (tualetëve, ujë të pijshëm, tavolina dhe banka për pushim, hapësira për ndërrimin e veshmbathjeve, duke përfshirë edhe hapësira të veçanta për fëmijë);
- Shpërndarja e barabartë e ndihmës humanitare si: ujë, ushqim, veshmbathje sipas nevojës, dhe pako për higjienë personale. Mundësia e ofruar e ekipeve të Kryqit të Kuq, që të mund të intervenojnë dhe të ofrojnë ndihmë tek më shumë persona.

Nr.	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Afati kohore për realizim të investimit	Kosto buxhetore	Kosto shtesë buxhetore
<b>1.</b>	Themelimi i Pikave të Pritjes për Migrantë, afër pikave kufitare hyrëse dhe dalëse të Kosovës.	MPB	IOM, UNHCR, Komuna, FSK, Organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.	10 ditë kalendarike (data e fillimit dhe e mbarimit DD)	<b>391,800.00</b>	
<b>1.1</b>	Përgatitja e plan-projektit për organizimin e hapësirës infrastrukturore të rrjetit dhe lejes nga autoritetet lokale për pikat ndihmëse.	MPB	MAPL, MMPHI, Komunat, FSK, UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	3 ditë	1, 500.00	
<b>1.2.</b>	Nivelimi i terrenit në lokacionin (e dhënë në dispozicion) përgatitur.	MPB	FSK, KFOR, UNHCR, IOM Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	2 ditë	5,000.00	
<b>1.3.</b>	Rrethoja e terrenit (10.000 metra).	MPB	FSK, KFOR, UNHCR, IOM Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	3 ditë	15,000.00	
<b>1.4.</b>	Vënia e një shtrese për ndërtim (tenda apo shtëpiza si modele 250 m <sup>2</sup> në lokacionet e zgjedhura).	MPB	FSK, KFOR, UNHCR, IOM Organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.	1 ditë	40,000.00	
<b>1.5.</b>	Instalimi i rrjetit të ujësjellësit (marrëveshje me kompaninë e ujësjellësit).	MPB	Ujësjellësi Rajonal, Komuna, UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	5 ditë	2,000.00	
<b>1.6.</b>	Instalimi i energjisë elektrike në lokacionin e zgjedhur.	MPB	UNHCR, IOM, KEDS, Organizatat tjera vendore.	5 ditë	2,000.00	
<b>1.7.</b>	Ndriçimi i jashtëm dhe i brendshëm.	MPB	KEDS, FSK, KFOR, Komunat, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	10 ditë	1,000.00	
<b>1.8.</b>	Vendosja e kontejnerëve dhe shportat e mbeturinave (2 kontejnerë të mëdhenj, 20 shporta).	MPB	IOM, UNHCR, Organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare.	1 ditë	300.00	
<b>1.9.</b>	Hapësirat për regjistrim, administratë, shërbim shëndetësor dhe salla e ngrënies.	MPB	FSK, MSH, UNHCR, IOM. Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	5 ditë	Kosto administrative	

1.10.	Sigurimi i pajisjeve teknike për regjistrim (aparate për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, kompjuter, lap top, printer mobil, etj.).	MPB, PK	UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	5 ditë	Kosto administrative	
1.11.	Pajisje për ngrohje.	MPB	UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	2 ditë	20.000.00	
1.12.	Vendosja e 7 tualeteve.	MPB	UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	3 ditë	12,000.00	
1.13.	Pajisja e sallës së ngrënies me tavolina dhe karrige.	MPB	UNHCR, IOM, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	5 ditë	2,000.00	
1.14.	Higjiena personale (dorashka për një përdorim, sapun i lëngshëm për duar, dezinfektues për personat që janë në kontakt direkt me refugjatë/migrantë).	MPB, Operatori Ekonomik	UNHCR, IOM, JRS, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	2 ditë	1.000.00	
1.15.	Produktet për pastrim higjienik (domestos, xhoker, lecka për pastrim).	MPB, Operatori Ekonomik	UNHCR, IOM, JRS, Organizatat vendore dhe ndërkombëtare.	2 ditë	1,000.00	
